

## RISHPALLJE

# THIRRJE PËR APLIKIM PËR DREJTOR EKZEKUTIV TË FONDACIONIT “DURRËS CITY”

Bazuar në ligjin nr. 7850, datë 29.7.1994 “Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjin nr. 8788, datë 7.5.2001 “Për organizatat jofitimprurëse”, i ndryshuar, ligjin nr. 80/2021 “Për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse” ligji nr. 79/2017, “Për sportin”, i ndryshuar, vendimin nr. 523, datë 22.09.2021 i Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit”, i ndryshuar, si dhe në vijim të thirrjes së mëparshme në përfundim të të cilës nuk ka pasur kandidatë që kanë aplikuar, rishpallet thirrja publike për pozicionin “Drejtor Ekzekutiv” i Fondacionit “Durrës City”, si më poshtë:

### **Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet dhe kriteret si vijon:**

- a) Të jetë shtetas shqiptar ose i huaj, rezident në Shqipëri.
- b) Të mos jetë i dënuar për kryerjen e një veprë penale.
- c) Të ketë mbaruar arsimin e lartë (preferohet në fushën e sportit, juridike apo ekonomike) brenda apo jashtë vendit.
- d) Të zotërojë kualifikime të tjera, trajnime dhe eksperiencë profesionale të profilit.
- e) Preferohet të ketë një përvojë pune në menaxhimin e projekteve të financuara nga donatorë të ndryshëm.
- f) Të zotërojë gjuhën angleze në nivel shumë të mirë (të folur dhe të shkruar).
- g) Të paraqesë 2 rekomandime nga punëdhënësit e mëparshëm.

### **Detyrat e Drejtorit Ekzekutiv:**

- a) Drejtori Ekzekutiv siguron mbarëvajtjen administrative dhe financiare të Fondacionit dhe ushtrimin e veprimtarisë së tij në përputhje me qëllimin e deklaruar;
- b) përfaqëson Fondacionin në marrëdhënie me subjektet, private ose publike, të tilla si donatorë apo subjekte të tjera private, si dhe me të gjitha nivelet e qeverisjes që rregullojnë veprimtarinë e organizatës;
- c) bashkëpunon me Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave për të siguruar që organizatat partnere dhe ato që sigurojnë financim, shërbime dhe mbështetje materiale nuk përdoren apo manipulohen për qëllime terroriste;
- d) zbaton me korrektësi statutin dhe vendimet e Bordit Drejtues;
- e) Lidh kontratat e punës me stafin e Fondacionit duke përdorur metodën e konkurrimit të hapur e të lirë, sipas kriterëve të përcaktuara nga Bordi Drejtues.

### **Dokumentacioni i kërkuar:**

Kandidatët paraqesin nëpërmjet e-mail-it në adresën [info@arsimi.gov.al](mailto:info@arsimi.gov.al), dokumentet si më poshtë:

1. Kërkesa me shkrim e shoqëruar me fotokopjen e dokumentit të identifikimit.
2. Jetëshkrimi (CV) sipas formatit standard (Europass).
3. Fotokopje e noterizuar e diplomës/diplomave/kualifikimeve/trajnimeve.
4. Certifikatë/diplomë të njohjes së gjuhës shqip, për kandidatët që kanë vetëm shtetësi të huaj.
5. Fotokopje të librezës së punës.
6. Vërtetim i gjendjes gjyqësore (Dëshmi Penaliteti) <https://e-albania.al/eAlbaniaServices/>

7. Çdo dokumentacion që provon aftësitë profesionale dhe organizative (vitet e punës në pozicione drejtuese etj.)

Në përfundim të vlerësimit të dosjeve çdo kandidat do të njoftohet në adresën e e-mailit të paraqitur.

**Shënim:**

**Dorëzimi i dokumenteve bëhet nga data 01.06.2023 deri më datë 09.06.2023, nëpërmjet email-it në adresën info@arsimi.gov.al.**